

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT NGA TE GJITHA RREZIQET NE NDERTIM

DISOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria e Sigurimeve "ANSIG" sh.a., ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "**Siguruesi**"

Personat juridike dhe fizike qe hyne me marredhenie sigurimi me "Siguruesin", ketu me poshte do te quhen shkurtimisht "**I Siguruarit**".

Sigurimi nga te gjitha rreziqet ne ndertim me poshte do te quhet shkurtimisht **CAR**.

OBJEKTI DHE RREZIQET

Sigurimi CAR mund te zbatohet per te gjitha **projektet inxhinjrike**, te tilla si:

- Ndertesa banimi, zyra, spitale, e objekte te tjera social-kulturore.
- Fabrika, uzina, hidrocentrale e termocentrale.
- Kruge, hekurudha e aeroporte.
- Ura, diga, tunele, siteme ujitje e dranzahimi, kanale e porte.

Sigurimi CAR mbulon:

- Operacionet qe kryen nje ndertues** dhe neendertesit e tij sipas kontrates se ndertimit, duke perfshire punen pergitore **ne sheshin e ndertimit, si dhe materialet e ndertimit te magazinuara** ne kete shesh. Perfshihet ne sigurimin CAR edhe vendosja e montimi e makinerive dhe pajisjeve te ndertimit, si dhe skelave metalike, me kusht qe vlera e tyre te jete me pak se 50 % e shumes se siguruar.
- Ngrehinat provizore per strehimin e puntoreve apo depozitimin e materjaleve ne sheshin e ndertimit.
- Shpenzimet e kryera per levizjen e **mbeturinave** nga sheshi ndertimit edhe ne rastet e nje demi te pagueshem sipas ketyre kushteve

Sigurimi CAR mbulon:

- Demet trupore aksidentale te paleve te treta.**
- Demet pasurore qe i perkete paleve te treta.**

Siguruesi do te jete pergjegjes per demet e mesiperme ndodhin ne objektet e siguruara sipas nenit 3. gjate kohes qe kontrata e sigurimit eshte ne fuqi.

Rreziqet kryesore qe mbulohe nga sigurimi CAR jane:

- Zjarri, rrufeja, eksplozioni, renija e avjonit ose e ngarkesave te tij.
- Shiu, debora, orteku i debore.
- Stuhia, cikloni etj.

Gjithashtu mbulohe demet e materjaleve te ndertimit, makinerive e paisjeve te ndertimit, te ndodhura gjate transportit brenda sheshit te ndertimit, ne magazine, ose gjate grumbullimit apo shperndarjes se materjaleve te ndertimit, brenda sheshit te ndertimit.

Sigurimi CAR, sipas kushteve te vecanta, te percaktuara ne anekset perkatese, kundrejt pagimit te nje primi shtese, mbulon edhe rreziqet e meposhteme:

- vjedhja e grabitja,
- grevat dhe trubullirat civile,
- paga per punen jashte kohes normale, puna naten, puna ne ditet e pushimit zyrtar, transporti ajror,
- objekte te marra ne dorezim ose te vena ne shfrytesim,
- ndryshimi i grafikut te punimeve,
- termeti, vershimi e permbytja,
- demtimi i kabllove dhe tubacioneve nentokore, si dhe ndertimi i tuneleve e galerive,
- ndertimi i digave dhe rezervuareve te ujit,
- demtimi i makinerive, paisjeve dhe materjaleve te ndertimit.
- shtrimi i tubacioneve te ujit dhe ujrave te zeza.

PERJASHTIMET

Sigurimi CAR nuk mbulon demet nga:

- lufta, lufta civile, invadimi, veprimet luftarake, rebelimi, trazirat politike, eksodi, kryengritja, grushti i shtetit, nderperjra e punes nga punedhenesi, konfiskimi, prishjet e urdheruara nga organet kompetente, reaksionet e radiacionet berthamor, ose ndotjet radioaktive,
- aktet keqdashese ose pakujdesi e rende e te siguruarit ose pefaqsesit te tij,
- demet e cdo lloji si gjoba, humbje per shkak te vonese ose zgjidhjes se kontrates,
- deme per shkak te projektit te gabuar,
- amortizimi, gryerja, oksidimi, renija e cilesive per shkak te mosporderimit dhe konditave normale atmosferike, si dhe shpenzimet e zevendesimit e te riparimit te materjaleve difektoze
- demtimi e humbjet e zbuluara vetem gjate kohes se kryerjes se inventarit.

Siguruesi nuk do te paguaj te siguruarin edhe per perjashtimet e vecanta per pergjegjesine ndaj paleve te treta si me poshte:

- shpenzime e kryera per mbulimin e demeve per te cilat siguruesi pergjigjet sipas nenit e te ketyre Kushteve
- demtimet e cdo pasurie, toke ose ndertese shkakuar nga vibrimet, ose levizja e dopsimi i bazes mbeshtetese, si dhe plagosja ose demtimi i cdo personi, shkakuar ose rjedhur nga nje demi i tille, cdo aksident i shkakuar nga mjetet motorike, aeroplani ose mjete lundrues.
- Per cdo police CAR do te zbatohet pjesa e zbrishtese e cila do te jete per cdo objekt te siguruar ose pjesa te tij nga 5 deri 20 per qind e shumes se siguruar. Kjo shume do te zbritet per cdo rast demi.

SHUMA E SIGURUAR, TARIFA DHE PRIMI I SIGURIMIT

Shumat e siguruara do te jene :

- Per pjesen ndertimore/materiale:

vlera e plote e punimeve qe kryhen deri ne kompletimin e ndertimit, duke perfshire te gjitha materialet, pagat transportin e taksat doganore, vlera e materjaleve ose punimeve te ndertimit qe kryhen nga investitori, vlera e zevendesimit e makinerive dhe paisjeve te ndertimit, shpenzimet per pastrimin e mbeturinave, ne rastin e ndodhjes se nje demi te mbuluar sipas Kushteve.

- Per pergjegjesine ndaj paleve te treta:

- Kufiri i demshperblimit per demet trupore qe u shkaktohen paleve te treta,

- Kufiri i demshperblimit per demtimin e pasurise qe u shkaktohet paleve te treta.

Kufijte e demshperblimit sa me siper percaktohen ne marreveshje midis Siguruesit dhe te Siguruarit.

I Siguruarit duhet te njoftoje Siguruesin per cdo ndryshim te vlefes se plote te punimeve qe kryhen deri ne perfundimin e ndertimit, ndryshim ky qe mund te vije si rrjedhoje e ndryshimit te cmimeve te materialeve te ndertimit, pagave te punes dhe tarifave.Me marrjen e njoftimit, Siguruesi ben shenimet perkatese ne policen e sigurimit.Ne rast se i Siguruarit nuk ben njoftimin e mesiperme, do te zbatohet neni 15 i ketyre kushteve.

Vlefte e zevendesimit te makinerive e paisjesve do te jete shuma e shpenzimeve per zevendesimin e tyre me te tjera te te njejtij lloj dhe kapacitet.

Shuma e siguruar per pastrimin e mbeturinave ne rastin e ndodhjes se nje demi te mbulueshem sipas ketyre kushteve, percaktohet ne pershataje me vleren totale te objektit qe ndertohe.

Mbulimi i pergjegjesise ndaj paleve te treta behet me nje kufi te caktuar demshperblimi per cdo nje aksident ose nje seri aksidentesh qe ndodhin ne cdo nje ngjarje te mbulueshme sipas ketyre kushteve.

Mbasi te Siguruarit t'i jete paguar demshperblimi per mbulimin e pergjegjesise se tij ndaj paleve te treta, Siguruesi ka te drejte t'i kerkoje te Siguruarit primin e plote te sigurimit ose te nje pjese te tij, si te jete rasti, per te realizuar vazhdimesine e sigurimit me po ate kufi demshperblimi qe eshte percaktuar ne kohen e lidhjes se kontrates se sigurimit.Ne qofte se shuma e siguruar eshte me e vogel se vlefte e objekteve te siguruara ne kohen e ndodhjes se ngjarjes se siguruar (nensigurimi), Siguruesi pergjigjet per demtimin vetem ne ate raport qe qendron shuma e siguruar ndaj vlefes se objekteve te siguruar ne kohen e ndodhjes se demit.

Cdo objekt dhe pjesa e objektit ose pjese e shumes se siguruar I nenshtrohet ketij rregulli.

Ne qofte se del qe shuma e siguruar tejkalon ne menyre te dukshme vleften e siguruar, Siguruesi po ashtu si dhe i Siguruarit mund te kerkojne qe, me qellim qe te menjanohe mbisigurimi, shuma e siguruar te reduktohet dhe si rrjedhoje te reduktohet me efekt te menjehershem dhe perpjestimisht edhe primi i sigurimit.

Ne qofte se i Siguruarit lidh kontraten e sigurimit me qellim qe te realizoje nje preparesi te paligjeshme financiare nepermjet mbisigurimit, kontrata konsiderohet e pavlefshme.

Siguruesi ka te drejten, pervec kur ai kishte dijeni per pavlefshmerine ne kohen e lidhjes se kontrates, per te marre primin respektiv deri ne fund te periudhes se sigurimit gjate se ciles ai merr dijeni per te.

Siguruesi merr parasysh faktoret e meposhtem per logaritjen e tarifes se primet te sigurimit:

- kushtet dhe ekspozimi ndaj rrezeqeve ne sheshin e ndertimit (si.zona sizmike, afersia me lumenj,kenetore,etj.),
- karakteristikat e projektit te ndertimit dhe materialeve te ndertimit qe do te perdoren,teknikat e ndertimit,
- pervoja e ndertesues ne zbatimin e ketij lloji projekti ose teknikave te ndertimit,
- mjete mbrojtese te parashikuara per t'u vendosur ne sheshin e ndertimit sipas grafikut te punimeve,
- masat e parashikuara per te garantuar zbatimin e projektit.

Tarifa e primet te sigurimit percaktohet nga Siguruesi per cdo kontrate te vecante.

Per kontratat e sigurimit CAR me afat deri ne nje vit, primi i sigurimit paguhet nga i siguruarit ne keto menyra:

- Me nje keste, ne kohen e lidhjes se kontrates se sigurimit.
- Me dy keste, kesti i pare i cili nuk mund te jete me pak se 60 % e primet total te sigurimit, Ne rastin e pageses se primet me dy keste, kur i siguruarit nuk paguan ne afatin e caktuar kestin e dyte, Siguruesi ka te drejte te zgjidhe kontraten e sigurimit. Ne kete rast Siguruesi mbete pergjegjes per demin e ndodhur gjate kohes qe kontrata e sigurimit ka qene ne fuqi, ne perpjestim te drejte me masen e primet te paguar me kestin e pare.

KONTRATA E SIGURIMIT, Kontrata e sigurimit mund te lidhet nga:

- Investitori

- Ndertuesi i ngarkuar per zbatimin e projektit duke perfshire te gjitha neendertesit.

I siguruarit ne kohen e lidhjes se kontrates, duhet ti paraqese siguruesit nje kerkese me shkrim e cila permban te gjitha te dhenat dhe rrethanat qe njihen nga ai dhe qe jane thelbesore per vleresimin e rrezeqeve.

Siguruesit duhet ti krijohe mundesite te kontrolloje kontraten e ndertimit, projektet, skicat, specifikitmet, grafikonet e punimeve, preventivat si edhe te dhenat e tjera te nevojshme, qe ai te kete mundesi per logaritjen e primet te sigurimit.

Siguruesi ka te drejte te beje verifikim e deklarimeve te bera nga i siguruarit ne kerkesen per sigurim.

Kontrata e sigurimit CAR konsiderohet e lidhur kur ajo i dorezohet te Siguruarit, mbasi ky i fundit te kete paguar primin e sigurimit ose kestin e pare.

Kontrata e sigurim CAR behet ne dy kopje, origjinali i dorezohet te siguruarit dhe kopja mbahet nga Siguruesi.

Pergjegjesia e Siguruesit fillon ne daten e shenuar ne police, por paravisht ne se data eshte caktuar, pergjegjesia fillon menjehere me fillimin e punes ose pas shkarkimit te artikujeve te permdurura ne formular, ne vendin e punes.

Pergjegjesia e Siguruesit mund te shtrihet edhe per nje periudhe mirembajtje, por duke bere nje deklarim te vecante ne kontrate dhe mbaron ne afatin e shenuar ne kontrate.

Ne rastet kur objekti i siguruar, ose pjese te tij, eshte perfunduar ose eshte vene ne shfrytezim, perpara perfundimit te kontrates se sigurimit, pergjegjesia e Siguruesit mbaron me perfundimin e objektit te siguruar ose pjeseve te tij.

Percaktimi i mesiperme eshte e zbatueshem edhe per makinerite, paisjet dhe materialet e ndertimit.

Ne qofte se zbatim i projektit me nuk perfundon brenda periudhes se mbulimit ne sigurim (afatit te percaktuar ne kontraten e sigurimit CAR), kjo e fundit, me kerkesen e te Siguruarit, mund te zgjatet edhe per nje periudhe tjeter kohen.

Mbulimi, per periudhen mbas asaj qe eshtwe percaktuar ne kontraten e sigurimit, do te jete e vlefshme vetem mbas konfirmimit te siguruesit dhe pagese se nje primi shtese.

Detyrimet e te Siguruarit

I Siguruarit ka per detyre qe te marre me shpenzimet e veta te gjitha masat e nevojshme paraprake per parandalimin e humbjeve apo demeve ose pergjegjesine dhe te veprojte ne kerkohen nga rrethanat e krijuara. Ne rastet qe rrethanat e reja do te rregullohet shtrirja e mbulimit dhe/ose primi i sigurimit.

Ne perthje se Siguruesi konstaton deklarime qe ndryshojne ne menyre te dukshme nga gjendja reale, ai ka te drejte te ndryshoje ose te zgjidhe kontraten e sigurimit. Ne rastin e zgjidhjes se kontrates se sigurimit, Siguruesi nuk i kthen te Siguruarit primin e sigurimit per periudhen deri ne zgjidhjen e kontrates dhe ne rast te ndodhjes se nje humbje ose demi, nuk paguan demshperblimin.

Siguruesi do te kete, ne cdo kohe, te drejten per te inspektuar dhe kontrolluar rrezikon.

I Siguruarit do ti paraqese Siguruesit ose pefaqsesve te tij te gjitha te dhenat dhe informacionin e nevojshem per vleresimin e rrezikut.

Mbas ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, Siguruesi dhe i Siguruarit kane te drejte te zgjidhin kontraten e sigurimit. Zgjidhja mund te kryhet vetem brenda nje muaji pas perfundimit te bisedimeve per demshperblimin, duke dhene njoftim me shkrim palest tjeter.

Ne qofte se kontraten e sigurimit e zgjidh i Siguruarit, Siguruesi ka te drejten e marrjes se primet te sigurimit per periudhen e sigurimit ne vazhdim.

Ne qofte se kontraten e sigurimit e zgjidh Siguruesi, zbatohet i njejti parim si me siper lidhur me pjesen e primet te sigurimit qe i korespondon demshperblimit te paguar dhe pjeses se primet qe i korespondon periudhes se sigurimit perpara zgjidhjes se kontrates se sigurimit.

DEMShPERBLIMI

Siguruesi demshperblen te Siguruarin brenda periudhes se sigurimit ne lidhje me nje demtim ose pergjegjesi me ate te pageses, zevendesimit ose riparimit (sipas variantit qe do te bien dakort palet) deri ne nje vlere qe nuk kalon, ne lidhje me secilin prej zerave te siguruar, shumen e siguruar perkatese dhe shumen totale te siguruar.Siguruesi nuk eshte i detyruar te demshperbleje te Siguruarin per me shume se vlera e demit edhe ne qofte se shuma e siguruar eshte me e madhe se vlera reale e objektit te siguruar ne kohen e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit.

Detyrimet dhe te Drejtat e te Siguruarit ne rast demi

Ne rastin e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit i Siguruarit duhet:

- Te njoftoje menjehere me shkrim Siguruesin duke dhene njoftim per natyren dhe shtrirjen e demit.
- Te marre te gjitha masat per te paksuar demin.
- Te ruaj pjeset e prekuara nga demi ne menyre te tille qe te kihet mundesi te inspektohen nga Siguruesi Te jape te gjitha informacionin dhe provat dokumentare qe mund te kerkohe nga Siguruesi.
- Te informoje policine ne rastet e demtimet te objekteve te siguruar te shkaktuara nga vjedhja ose grabitja. Siguruesi ne asnje rast nuk do te jete pergjegjes per demin ose pergjegjesine, per te cilat ai nuk ka marre nga i Siguruarit asnje njoftim brenda 10 diteve nga ndodhja e tyre.

Me njoftimin e dhene Siguruesit sipas nenit 32 te ketyre Kushteve, Siguruesi ose pefaqsesi i tij do te kryej inspektimin e demit, perpara kryerjes se riparimit ose zevendesimit, brenda 15 diteve nga data e njoftimit.

Ne qofte se Siguruesi nuk kryehen inspektimin brenda afatit te percaktuar ne kete nen, i Siguruarit ka te drejte te filloje riparimet ose zevendesimet.Pergjegjesia e Siguruesait, per cdo objekt ose ze te siguruar, te demtuar do te pusbjose se ekzistuar ne qofte se riparimi nuk eshte bere ne menyre te kanaqeshme per Siguruesin.

Demet materjale

Ne rastin e ndodhjes se rasti te sigurimit masa e demshperblimit do te jete:

- Ne rastin e demeve te cilat mund te riparohen, shpenzimet e riparimit te nevojshme per ti kthyer objektet ne gjendjen qe ato ishin menjehere perpara ndodhjes se demit minus pjese e shpetuara.
- Ne rastin e humbjes totale, vlefte aktuale e objekteve menjehere perpara ndodhjes se demit minus pjeset e shpetuara.

Ne te gjitha rastet demshperblimi do te behet brenda kufijve te shumes se siguruar duke patur parasysh gjithmone se jane zbatuar te gjitha rregullat e parashikuara ne keto Kushte.

Shpenzimet e riparimit ose zevendesimit, te cilat nuk kryhen si pasoje e ndodhjes se nje ngjarje sigurimi, nuk demshperblehen. Gjithashtu Siguruesi nuk mbulon shpenzimet per cdo ndryshim, shtese ose permiresim.

Demshperblimi per pergjegjesine ndaj paleve te treta

Siguruesi demshperblen te Siguruarin, pervec asaj qe ka paguar lidhur me mbulimin e demeve te percaktuar ne nenin 4, edhe per:

- Te gjitha shpenzimet gjyqsore te paguara paditesve nga i Siguruarit.
- Te gjitha shpenzimet e kryera nga ai me miratim me shkrim nga Siguruesi.

Pergjegjesia e Siguruesit per te paguar demshperblim lidhur me demet ose shpenzimet e mbulueshme sipas nenive 4 dhe 38 te ketyre Kushteve, nuk do te jete me e madhe se kufijte e demshperblimit te percaktuar ne kontraten e sigurimit CAR.

Siguruesi mund ti paguaj te Siguruarit, per cdo aksident, qe lidhet me pergjegjesine e tij, nje shume te barabarte me kufirin e demshperblimit per cdo aksident, por duke i zbritur ne nje rast te tille shumen ose shumat qe tashme jane paguar si demshperblim per kete aksident.Siguruesi detyrohet ti paguaj te Siguruarit demshperblimin brenda dy muajve nga data e marrjes se kerkeses per demshperblim. Ne qofte se Siguruesi nuk paguan demshperblimin brenda afatit dy mujor, ai detyrohet ti paguaj te Siguruarit nje interesi mbi shumen e demshperblimit, i cili do te jete i barabarte me interesin bankar per logaritje likuiduese, ne daten e perfundimit te afatit dy mujor.Afatit dy mujor per pagesen e demshperblimit pezullohet ne ato raste dhe per aq kohen sa demshperblimi nuk mund te paguhet, ose pecaktohet per shkak te te metave te te Siguruarit.

Refuzimi ose pezullimi i kerkeses per demshperblim

Siguruesi ka te drejte te refuzoje ose pezulloje kerkesen per demshperblim te te Siguruarit ne qofte se:

- Ka dyshime persa i perkete te drejtes se te Siguruarit per demshperblim, duke pritur provat e nevojshme.
- Ne lidhje me kerkesen per demshperblim te te Siguruarit ka filluar ceshtje penale, deri ne perfundimin e ceshtjes. Kontrata e sigurimit do te quhet e pavlefshme dhe Siguruesi nuk do te jete pergjegjes per te demshperblyer te Siguruarin, ne qofte se kerkesa per demshperblim eshte bere e mbeshetur ne mashtirimin e zmadhuar ne menyre esenciale, ose ne qofte se faktet jane pasqyruar ne menyre te rreme ne mbesheteje te mashtirimin ose zmadhimin esencial.Ne qofte se Siguruesi refuzon kerkesen per demshperblim te te Siguruarit dhe ne qofte se nuk eshte ngritur padi ne gjykate brenda afateve te percaktuara ne legjislacionin shqiptar, i Siguruarit e humbet te drejten per te perfutur demshperblimin ne lidhje me ate kerkese.Pas pageses se demshperblimit, objektet ose zerat mbeten te siguruarat deri ne perfundim te kontrates se sigurimit, per diferencen midis shumes se siguruar dhe demshperblimit te paguar, duke bere per kete shenimet perkatese ne kontraten e sigurimit.
- Siguruesi, mbasi i ka paguar demshperblimin te Siguruarit, ka te drejte te kerkoje kthimin e shumes se paguar nga personat qe jane pergjegjes per shkaktimin e demit.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis Siguruesit dhe te Siguruarit, kur ato nuk zgjidhen me mirekuptim midis tyre, zgjidhen nga gjykata e rrethit ku eshte lidhur kontrata e sigurimit